

VENDIM
Nr. 523, datë 13.6.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 70, DATË 11.2.1999 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR EVIDENTIMIN E PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 29 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 70, datë 11.2.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i fundit i pikës 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Zyra përkatëse e punësimit pajis me kartë papunësie çdo punëkërkues të papunë që përfiton ose do të përfitojë nga ofrimi i shërbimeve dhe programeve aktive të punësimit, si dhe nga programet e tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura.”.

2. Paragrafi i parë i pikës 6, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Shërbimi Kombëtar i Punësimit nxjerr dhe pajis falas me kartë personale papunësie të gjithë personat që regjistrohen si punëkërkues të papunë. Zyrat e punësimit kryejnë procesin e pajisjes me kartë papunësie dhe bëjnë vërtetimin e të qenit punëkërkues i papunë të mbajtësit të kartës. Pajisja me karta papunësie për punëkërkuesit e papunë fillon menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përfundon brenda tre muajve. Karta e papunësisë është dokumenti i vetëm zyrtar, i cili paraqitet për përfitimet e shërbimeve të punësimit dhe përfitimet nga skemat e mbrojtjes shoqërore.

Pas përfundimit të afatit tremujor, shërbimet e sipërpërmendura do t’u ofrohen vetëm punëkërkuesve që janë pajisur me kartë papunësie.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha